

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. **Z. Egzon Haradinaj**, inspektor në Drejtorinë për Inspektim në Vushtrri, i lejohet mbushje mujore të telefonisë mobile të Vala-s në shumë prej 10,00 € si dhe qasja në rreth pa pagesë. Nr. tel 044/899128.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, pas konsultimeve me përfaqësues të këshillave të fshatrave, shoqërinë civile Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

1. Formohet grupi punues për mbështetje në proceset e vendimmarrjes së qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 **Islam Latifi**, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Shef sektori
 - 1.2 **Megjit Perquku**, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Shef sektori
 - 1.3 **Faton Behrami**, Administrata e Kuvendit, Asistent i Kryesuesit të Kuvendit
 - 1.4 **Ekrem Merovci**, Zyrtar në ZKKK
 - 1.5 **Emin Latifi**, Përafqesues i fshatrave Ortakoll
 - 1.6 **Fatmir Feka**, Përafqesues i fshatit Karaqë
 - 1.7 **Bajram Lahu**, Përfaqësues i qytetit Vushtri
 - 1.8 **Gani Hasani**, Përafqesues i fshatit Bajske
 - 1.9 **Bratislav Kostic**, Gojbulë
 - 1.10 **Sasa Andric**, Prelluzhë
 - 1.11 **Vlora Krasniqi**, Kryetare e KVLR
 - 1.12 **Blerim Ibrahim**, OJQ 'Stand Out'
 - 1.13 **Sevdije Voca**, Shoqata për të verbrit 'Drita jonë'
2. Grupi punues në fjalë i cili përfaqëson Administratën e Komunës, Këshillat e fshatrave dhe Shoqërinë Civile do të mbështesë komunën në ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse komunale.
3. Anëtarët e grupit punues do të kenë mandate deri në përfundim të projektit.
4. Grupi Punues do të funksionojë në bazë të udhëzuesit dhe planit vjetor të punës.
5. Kryetari i Komunës ka të drejt të kërkoj nga ky grup raport për punën vjetore dhe të arriturat në të mirë të qytetarëve të tyre.



Kryetari i Komunës

Z. Bajram Mulaku



Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenit 7 të Ligjit të punës nr 03/L-212, Kryetari i Komunës, bien:

V E N D I M

I. Formohet komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar për vendin e punës: **Vozitës në Drejtorinë për Shërbime Publike-Komuna Vushtrri**


II. Komisioni ka këtë përbërje:


1. Islam Latifi ,Kryesues i komisionit
2. Driton Dallku, ,anëtar i komisionit
3. Gjylsime Feka, ,anëtare e komisionit
4. Marina Rakiq, anëtare e komisionit
5. Jeton Salihu, anëtar i komisionit

III. Komisioni ka për detyrë që ti kontrollojë të gjitha aplikacionet dhe të i intervistojë kandidatët.



Kryetari i Komunës


Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt. 05.02.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës, njësia buxhetore – Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere, lejohen mjete financiare në shumë prej 200,00 €, (dyqind euro) për komunitetin Ashkali në Komunën e Vushtrrisë, për shënimin e Ditës së Flamurit të këtij komuniteti.
2. Pagesa të bëhet në llogari të z. Adem Hoti, përfaqësues i komunitetit Ashkali në Komitetin për Komunitete të KK-së Vushjtrri.
3. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për buxhet e financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
5. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “ f” dhe “g” të Statutit të Komunës, nenin 21 të Rregullores së MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 8 të Rregullës Financiare për Menaxhimin e Pasurisë Financiare të Komunës dt.464/14, dt. 20.03.2014, rekomandimit të komisionit për inventarizim të pasurisë jofinanciare të shëndetësisë nr.21, dt.26.01.2016 si dhe propozimit nr.60, dt.08.02.2016 të Drejtores së QKMF-së në Vushtrri , Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR VLERËSIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË SHËNDETËSISË NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për vlerësim të Pasurisë jo Financiare nga regjistri i pasurisë të shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Dr. **Shukri Gërxhaliu**, kryesues
 - 1.2 Dr. **Azize Maxhuni**, anëtar
 - 1.3 **Veton Topxhiu**, anëtar
2. Komisioni nga pika paraprake e këtij vendimi do të kryej detyrat e tij në pajtim me nenin 9 dhe 21 pika 4 të Rregullores së MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenin 9 të Rregullës financiare për Menaxhim të pasurisë jo financiare të komunës dt.464/14, dt. 20.03.2014.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Drejtores së QKMF-së, anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës 02nr.000989, dt.23.01.2016, në shumë prej 624,60 € (gjashtëqindnjëzetekatëre euro e gjashtëdhjetë cent), për shpenzimet e krijuara në DPH "Vigu" Koshtovë me përfaqësues të Baletit Kombëtar të Kosovës dhe stafi i komunës (43 pjesmarrës).
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të deklaratës së "Child Chance Foundation" për dhurim të automjetit Mercedes-Benz viti i prodhimit 2006, dizel, ngjyrë e hirtë metalike, Kombi udhëtarësh, 3 dyer, për komunën e Vushtrrisë si dhe për nevoja të shoqatës "Handikos në Vushtrri", Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Automjeti zyrtar i komunës nr. tabelës së regjistrimit 02Z-29-27, Mercedes-Benz viti i prodhimit 2006, nr. i shasisë WDB9036721 R958649, dizel, ngjyrë e hirtë metalike, Kombi udhëtarësh, 3 dyer, lejohet që të shfrytëzohet nga Shoqata "Handikos" në Vushtrri, sa herë që e kërkojnë nevojat e kësaj shoqate.
2. Fehmi Ramadani, shofer në Shoqatën Handikos" në Vushtrri, nr. personal 1004745732, autorizohet që automjetin në fjalë ta shfrytëzoj për nevoja të kësaj shoqate.
3. Automjeti duhet të qëndroj në auto-parkun e komunës në rastet kur nuk shfrytëzohet nga Shoqata e cekur më sipër.
4. Përgjegjës për mbikëqyrjen e shfrytëzimit të automjetit do të jenë Shefi i auto-parkut të komunës dhe Drejtori i shoqatës "Handikos" në Vushtrri.
5. Deklarata e "Child Chance Foundation" për dhurim të automjetit bashkëngjitet në shtojcë të këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
7. Vendimi ju dërgohet: Shefit të autoparkut të komunës, drejtorit të shoqatës "Handikos" në Vushtrri dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Lejohet furnizimi me gazeta ditore për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë si vijon:
 - 1.1 Kryetari i Komunës: Zëri, Kosova Sot,
 - 1.2 Nënkyetari i Komunës, Koha Ditore, Kosova Sot,
 - 1.3 Zyra për Informim, Zëri, Koha Ditore.
2. Furnizimi sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi të bëhet nga dita e hënë deri në ditën e premte të secilës javë.
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik obligohen që të respektoj procedurat ligjore me rastin e zbatimit të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02nr.22/16, dt.12.01.2016.
6. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë për Prokurim Publik, dhe Arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Z. Nexhip Brahimi, shofer në zyrën e Kryetarit të Komunës, i lejohet mbushje telefonike mujore të telefonisë mobile të Vala-s, në shumë prej 10,00 € (dhjetë euro). Nr. i telefonit të të lartpërmendurit është, 044/186187.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa – zyrtarja e autorizuar për mbikëqyrje të marrëveshjes në fuqi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe PTK-së.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të filloj së zbatuari nga muaji shkurt 2016.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të lartpërmendurit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të ftesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 06-1636/2 dt.11.12.2015, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. **Z. Islam Latifi**, shef i sektorit për komunikacion në Komunën e Vushtrrisë, i lejohej pagesa e mëditjes për pjesëmarrje në punëtorinë e tretë me temën "Rishikimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale" në Durrës – Shqipëri, nga data 17-19.12.2015.
2. Pagesa e mëditjes të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Shërbime Publike.
3. Ftesa dhe agjenda nga MAPL si dhe lista e pjesëmarrësve me nënshkrime është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenin 3 pika 4 si dhe nenin 4 pika 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit 02nr. 88/16 dt.29.01.2016 në mes të Komunës së Vushtrrisë, Organizatës "Islamic Relief – Kosova dhe Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri për pranim të donacionit të pajisjeve dhe materialit shpenzues mjekësor , Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Z. Formohet komisioni për pranim të donacionit - pajisjeve dhe materialit shpenzues mjekësor për institucionet shëndetësore të nivelit parësor dhe dytësor në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 Naim Ferizi, DSHPS -Vushtrri
 - 1.2 Skender Hoxha, QKMF- Vushtrri
 - 1.3 Egzon Maloku, QKMF- Vushtrri
 - 1.4 Ekrem Saraçi, Spitali – Vushtrri
 - 1.5 Xhevat Avdiu, Spitali – Vushtrri
 - 1.6 _____, përfaqësues i Organizatës "Islamic Relief – Kosova
2. Komisioni në fjalë do të zbatoj me përgjegjësi të gjitha procedurat e nevojshme në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm dhe dispozitat e nenit 7 të marrëveshjes së bashkëpunimit 02nr. 88/16 dt.29.01.2016 për pranim dhe sistemim të pajisjeve dhe materialit shpenzues mjekësor për nevoja të shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë për nivelin parësor dhe dytësor .
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Spitalit "Sheikh Zayed", anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe duke iu referuar marrëveshjes bashkëpunim në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës 02nr.122/16 dt.05.02.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i sallës së sporteve të Gjimnazit "Eqrem Qabej" në Vushtrri për nevoja të ekipeve të basketbollit të Komunës së Vushtrrisë dhe shkollës së basketbollit të femrave gjatë sezonit 2016/2017. Koha e shfrytëzimit të sallës është nga ora 17;00 deri 22;00.
2. Mbikëqyrjen e shfrytëzimit të sallës do ta bëjnë: Zyrtari i autorizuar i Gjimnazit "Eqrem Qabej" në Vushtrri në bashkëpunim dhe koordinim me përfaqësuesit e autorizuar të Federatës së Basketbollit të Kosovës, për Komunën e Vushtrrisë.
3. Shfrytëzimi i sallës duhet të bëhet me përgjegjësi të plotë duke e ruajtur nga dëmtimet gjatë kohës që iu lejohet në dispozicion.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të Kujdesen: Drejtoria për Arsim, drejtori i Gjimnazit "Eqrem Qabej" dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtrri.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Arsim, Drejtorit të Gjimnazit "Eqrem Qabej", Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku